

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
KRYETARI

Nr. 2694 .Prot.

Berat,më 10/06/2020

V E N D I M
Nr. 351 datë 10/06/2020
PËR

SHTESA NË PLANIN VJETOR TË PRANIMIT PËR VITIN 2020 ,NË
INSTITUCIONIN E BASHKISË BERAT PJESË E SHËRBIMIT CIVIL

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjes Vendore”,neni 8 ,pika 2, neni 9 ,gërma b, të nenit 18 të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin Civil”, I ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr 108 , datë 26.02.2014”Për planin vjetor të pranimi të Shërbimit Civil”, vendimit nr.120, datë 21.02.2020“Për miratimin e Strukturës, Organigramës së Administratës së Bashkisë dhe të Njësitë Shpenzuese në varësi të Bashkisë Berat”, për vitin 2020, si edhe informacionin e Njësisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore për pozicionet e lira të krijuara në shërbimin civil në kategorinë e Ulët dhe të Mesme Drejtuese ,Kryetari i Bashkisë ,

V E N D O S I:

1.Numri i vendeve vakante që i shtohen planit vjetor të pranimi në shërbimin civil , në administratën e Bashkisë Berat, për vitin 2020, pjesë e shërbimit civil do të jetë **4(katër)** gjithsej sipas kategorive të mëposhtme :

a)Për kategorinë e Ulët Drejtuese **1(një)**pozicion

2.Drejtoritë ku planifikohet të shtohen vendet vakante janë

- Drejtoria e Shërbimit Social

b)Për kategorinë e Mesme Drejtuese **3 (tre)**pozicione

3.Drejtoritë ku planifikohen të shtohen vendet vakante janë :


- Drejtoria e Shërbimit Social
- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse
- Drejtoria e Emergjencave ,Pronave dhe Transportit

4.Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse , në cilësinë e njësisë përgjegjëse.

5.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.



KRYETARI I BASHKISË
Ervin Demo


REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
NJËSIA PËRGJEGJËSE E BURIMEVE NJERËZORE

Nr. 2644 / Prot.

Berat, më 10/06/2020

Lënda : Kërkesë për publikim, shtesa në Planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil

SHËRBIMIT KOMBËTAR TË PUNËSIMIT ,TIRANË

Në zbatim të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar ,neni 18 si dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.108 datë 26.02.2014 “Për planin Vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil”, bashkëlidhur po ju dërgojmë për publikim shtesa në planin vjetor të Pranimit në Shërbimin Civil të Bashkisë Berat për vitin 2020.

Faleminderit për bashkëpunimin dhe mirëkuptimin.

KRYETARI I BASHKISË
Ervin Demo

